



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.32.1-2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË HANIT TË**  
**ELEZIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015**

**Prishtinë, qershor 2016**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Hanit të Elezit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyr auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Astrit Bllaca, i mbështetur nga Fejzullah Fejza, (udhëheqës ekipi), dhe Ernes Beka.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	22
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	23
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	26


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2015 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 21.11.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih Shtojcën I të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:


“Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes” sepse ka paqartësi në prezantimin e plotë të vlerës së pasurive. Për më tepër pasuritë në vlerë 34,243€, nuk janë të regjistruara në regjistrin kontabël SIMFK.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi te nën kapitulli 1.2 i këtij raporti.

## Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm i vendosur nga komuna, funksionon në mënyrë efektive në disa fusha, por dobësitë ende janë të pranishme në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



## Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

# 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.2 Opinioni i auditimit

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën Financiare të MF nr. 03/2013 për Pasqyrat Vjetore Financiare të organizatave buxhetore.

### **Baza për Opinion**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të Pasqyrave Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushë në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që janë marrë, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion.

## **Theksimi i çështjes**

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se shpalosjet e pasurisë në PVF janë të nënvlerësuara, sepse nuk ishte regjistruar pasuria në vlerë prej 34,243€. Po ashtu, edhe shpalosjet e pasurisë nën 1,000€ ishin të nënvlerësuara për 4,224€. Arsyeja kryesore për këtë gabim është se komuna nuk kishte marrë masa të duhura për regjistrimin e tyre. Për çështjet e përmendura, ne nuk e kemi kualifikuar opinionin.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare**

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e

entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

### 1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

#### **Përshkrimi**

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 21.11.2015, janë identifikuar dy rreziqe për PVF-të. Këto janë rreziqe të keq deklarimeve materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Rreziku që ka të bëjë me regjistrimin e pasurive, është materializuar, sepse menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për të adresuar rrezikun e identifikuar.

Ne kemi vërejtur se komuna ende nuk kishte arritur të regjistroj tërë pasurinë të cilën e kishte përvetësuar. Në mes të raportit të shpenzimeve dhe regjistrit të pasurive në SIMFK- kishte diferencë prej 34,243€. Përveç kësaj, shpenzimet për pajisje/mobilje nën 1,000€ nuk ishin pasqyruar në vlerë të plotë në PVF, me ç'rast shuma prej 4,224€ nuk ishte përfshirë në regjistrin e pasurive nën 1,000€.

Ndërsa, rreziku i dytë domethënës që ka të bëjë me keqklasifikimin material të shpenzimeve në kategori të ndryshme nuk ka ndodhur për arsye se komuna kishte marrë masa adekuate për të eliminuar këtë rrezik.



## 1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, (me ndryshime dhe plotësime);;
- Kërkesat e buxhetit;
- Nëse PVF janë nënshkruar nga ZKF dhe Kryetari;
- Nëse PVF janë përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe;
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore në Kuvend Komunal; dhe
- Planin përfundimtar të prokurimit me kohë.

### DEKLARATA E BËRË NGA KRYETARI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë, përveç çështjeve të përmendura për pasuritë, por që nuk janë materiale për ta modifikuar opinionin.

## 1.5 Rekomandimet

**Rekomandimi 1 Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në Theksim të Çështjes. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet për mos regjistrim të pasurisë në SIMFK dhe të paraqitjes së saktë në PVF.

## 2 Qeverisja

### 2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo reflekton përkushtimin e menaxhmentit për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga komuna lidhur me vetëvlerësimin të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

### 2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekzistojnë ende disa dobësi të qeverisjes brenda komunës, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e cila ishte plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit, nuk janë të vendosura si duhet. Po ashtu, mungesa e një liste mbi rreziqet me të cilat përballet komuna janë indikator se qeverisja mbi sistemet kyçe të menaxhimit nuk është ende në nivelin e dëshiruar.

## 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 për Komunën e Hanit të Elezit ka rezultuar në tetë (8) rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2015, katër (4) rekomandime janë implementuar, dy (2) janë adresuar dhe dy (2) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III

Raporti i auditimit të vitit 2014, ishte diskutuar edhe në Asamblenë Komunale.

### Rekomandimi

---

#### Çështja 1 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Përkundër që pjesa më e madhe e rekomandimeve janë trajtuar nga ana e menaxhmentit, nuk është arritur që të adresohen të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi i vitit të kaluar. Kjo, për arsyen se komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të plotë të rekomandimeve.

**Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar në:

- Shfaqjen e dobësive në procesin e prokurimit dhe arritjen e vlerës për para dhe;
- Pamundësinë që menaxhmenti të konfirmojë plotësinë e pasurive në PVF.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjesisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.

## 2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetëvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në ministri nga ana e komunës, dhe kemi vlerësuar disa pyetje kyçe për komponentët e listës kontrolluese. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por pasqyron gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

---

### Çështja 2 - Lista kontrolluese e Vetëvlerësimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar disa pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1;
2. Komuna ka hartuar Planin Zhvillimor Strategjik. Në këtë dokument strategjik nuk janë të përcaktuara në tërësi kostot financiare për zbatimin e objektivave; dhe
3. Nuk janë hartuar plane të qarta veprimi për adresimin e rekomandimeve ku do të përcaktoheshin afatet dhe personat përgjegjës për adresimin e rekomandimeve.

Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2014 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda komunës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

**Rreziku** Mungesa e aranzhimeve të duhura të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

**Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive.

## 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore kanë detyrim të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara kërkojnë që komuna të ketë regjistrin e rrezikut i cili duhet të mbulojë të gjitha komponentat e rëndësishme të menaxhimit. Regjistri i rrezikut duhet të jetë i kompletuar për të mbështetur dhe adresuar sfidat dhe reagimin e menaxhmentit ndaj tyre, në funksion të një menaxhimi efektiv operacional dhe strategjik të komunës.

#### Rekomandimi

---

#### Çështja 3 - Mos zbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut - Prioritet i lartë

**E gjetura** Pyetëtori i vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka konfirmuar se komuna ende nuk ka identifikuar rreziqet të cilat do të kanosnin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.

**Rreziku** Mungesa e një regjistri të rreziqeve potenciale si dhe mungesa e qasjes dhe veprimeve për menaxhimin e tyre mund të reduktoj efektivitetin e komunës dhe të ndikoj në mos përmbushjen e objektivave dhe planeve të synuara.

**Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se pas hartimit të një liste të rreziqeve me nivelet përkatëse. Përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut është deleguar tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi mbarëvajtjen e procesit.

## 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna edhe për vitin 2015 nuk kishte themeluar NJAB si dhe nuk kishte shfrytëzuar shërbimet e auditimit të brendshëm nga jashtë (Ministria e Financave). Megjithatë në fillim të vitit komuna iu kishte drejtuar me kërkesë MF, respektivisht Njësisë Qendrore Harmonizuese të kryej një auditim për vitin 2015, kjo çështje ishte marrë në konsideratë nga MF , dhe maj të vitit 2016 kishte filluar auditimi për vitin 2015.

---

### Çështja 4 - Auditimi i Brendshëm - prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna edhe për vitin 2015 nuk kishte themeluar NJAB. Mos formimi i auditimit të brendshëm ka ndikuar në mungesën e sigurisë së menaxhmentit se aktivitetet dhe sistemet e kontrolleve të brendshme kanë qenë efektive në parandalimin e dobësive dhe lëshimeve të mundshme.
- Rreziku** Mos themelimi i NjAB zvogëlon sigurinë e menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Kjo mund të rezultojë me dobësi të pa identifikuar dhe me vazhdimin e praktikave joefektive, e që mund të rezultojnë me humbje financiare.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të konsiderojë mundësinë e sigurimit të shërbimeve të auditimit të brendshëm, në mënyrë që të testoj përshtatshmërinë, efektivitetin dhe operimin e kontrolleve të brendshme të organizatës.

## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Për komunën, prokurimi mbetet një segment të cilit duhet t'i kushtohet një rëndësi më e madhe duke kërkuar gjithnjë të zbatohen rregulloret relevante të kësaj fushe, në kontekst të sistemeve financiare, si dhe t'i kushtohet një rëndësi më e madhe edhe menaxhimit të pasurisë.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	<b>2,051,844</b>	<b>2,268,599</b>	<b>2,094,367</b>	<b>1,902,070</b>	<b>1,877,073</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,795,586	1,904,162	1,901,743	1,620,495	1,525,696
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	0	44,242	44,134	27,144	60,262
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	256,258	256,258	94,536	233,030	229,881
Donacionet e jashtme	0	63,937	53954	21,401	61,235

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 216,755€. Kjo është si rezultat i rritjes së Grantit Qeveritar prej 108,576€ (nga të cilat 100,000€ me vendim të Qeverisë, dhe pjesa tjetër për kompensimin e përvojës së punës), të hyrave të bartura prej 44,242€, dhe donacioneve të jashtme për 63,937€.

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Në vitin 2015, komuna ka ekzekutuar 93% të buxhetit final, një nivel pothuajse i njëjtë krahasuar me vitin 2014. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm, përveç tek investimet kapitale dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	<b>2,051,844</b>	<b>2,268,599</b>	<b>2,094,367</b>	<b>1,902,070</b>	<b>1,877,073</b>
Pagat dhe Mëditjet	1,358,378	1,368,293	1,366,432	1,239,194	1,067,784
Mallrat dhe Shërbimet	149,000	267,500	264,566	147,697	202,151
Shërbimet komunale	37,817	48,138	48,061	35,918	33,551
Subvencionet dhe Transferet	37,817	50,082	47,640	37,163	27,477
Investimet Kapitale	456,649	534,586	367,669	442,098	546,111

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

Komuna ka treguar performancë të mirë në realizimin e buxhetit në të gjitha kategoritë, me një përqindje të përafërt me planifikimin, përveç kategorisë investime kapitale ku nuk është treguar një performancë e mirë e cila e shprehur në progres është afër 69%, mjete të cilat nuk ishin shpenzuar, por që janë ndikuar edhe nga mos inkasimi i të hyrave të planifikuara.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	256,258	256,258	223,521	233,030	229,881

Plani i të hyrave për 2015 ishte realizuar 87%. Në mosrealizimin apo devijimin nga plani për 13% mund të ketë ndikuar vendimi i Qeverisë për faljen e borxheve të vjetra. Një shumë e konsiderueshme e të hyrave vetjake (129,094€) janë bartur si të hyra të pa shpenzuara në vitin 2016.



## Rekomandimi

---

### Çështja 5 – Dobësi në planifikimin e buxhetit – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Komuna ka bërë disa ndryshime buxhetore gjatë vitit 2015, por kërkesat e përgjithshme të buxhetit për shpenzime nuk janë përcaktuar në mënyrë adekuate, sidomos tek investimet kapitale, si dhe ngjashëm projeksionet e të hyrave do të duhej të rishikohen.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët në kategorinë e investimeve kapitale do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe shtyrjen e projekteve të vitit aktual tek buxheti i vitit të ardhshëm, duke e reduktuar mundësinë për t'i arritur objektivat e ardhme të komunës.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike dhe janë identifikuar barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.

## 3.4 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në proceset e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe ekzekutimin e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

## Rekomandimet

---

### Çështja 6 – Dobësi sistematike në prokurim – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Komuna ka përgatitur dhe dorëzuar me vonesë në AQP planin preliminar të prokurimit. Komuna kishte përgatitur planin preliminar me datë 22.01.2015 pas publikimit të ligjit të buxhetit apo me 83 ditë vonesë. Rëndësia e përgatitjes dhe dorëzimit të planit preliminar në AQP qëndron në atë që këtij agjencioni i mundëson të shqyrtojë dhe identifikojë artikujt e përdorimit të zakonshëm për prokurim përmes procedurës së përbashkët të prokurimit në emër të AK-ve.
- Në dy procedura të prokurimit, kemi vërejtur se të tri (3) ofertat e OE, janë të papërgjegjshme, pasi që asnjëra nuk e kishte plotësuar Formularin e Paraqitjes së Çmimeve. Kështu që rrjedhimisht edhe tenderi është i papërgjegjshëm dhe AK ishte dashur të anuloi procedurat dhe të filloj me procedura të reja të prokurimit.

Në dy raste ne kemi vërejtur se vendimi për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave ishte përgatitë vetëm nga menaxheri i prokurimit, pa aprovimin e ZKA-së.

Ne kemi vërejtur se komuna në 13 raste kishte lidhur kontrata me çmim për njësi duke mos specifikuar sasinë dhe vlerën e përafërt për furnizim, përkundër që njësia kërkuese në kërkesën e saj kishte bërë vlerësim të nevojave për sasinë e përafërt për furnizim.

**Rreziku**

Mos përgatitja e planit preliminar me kohë ndikon direkt në mangësitë e planit final, mos përfshirja e sasisë së nevojshme për furnizim dhe përdorja e çmimeve për njësi rrezikon që komuna të lidh kontrata me çmime më të larta, formimi i komisioneve të vlerësimit pa aprovimin e ZKA-së rrezikon që ato të kenë përbërje joadekuate. Këto mund të shpien drejt rrezikut për implementimin e plotë të projekteve dhe të sjellë vlerë të dobët për para.

**Rekomandimi 7**

Kryetari duhet të inicioj një analizë të plotë pse janë aplikuar praktika të dobëta të prokurimit në këto raste dhe të zbatojë kontrolle të shtuara të cilat sigurojnë se: prokurimet i reflektojnë nevojat; specifikacionet e tenderit i reflektojnë kërkesat aktuale të drejtorive. Në përgjithësi, kontrollet e prokurimit duhet të forcohen.

### 3.4.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet procesohen për pagesë përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave si aprovimi dhe futja në listë të pagave të punonjësve të rinj, verifikimi i numrit të lejuar dhe kontrollat tjera shoqëruese administrohen nga Ministria e Financave. Niveli i aprovimi i buxhetit për paga dhe mëditje bëhet nga Asambleja Komunale, derisa për aprovimin e shtesave përmbi paga si dhe ndryshimet e nevojshme në këtë cikël deri tek nënshkrimi i listave bëhet nga menaxherët përkatës të linjës.

---

#### Çështja 7 - Aplikim joadekuat i rregullores për kompensim të kujdestarive - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna kishte përshtatur rregulloren e brendshme për kompensim të kujdestarive për stafin mjekësor, me rregulloren organike të nxjerrë nga Ministria e shëndetësisë. Sipas rregullores organike kujdestaritë duhet të paguhet në pagën bazë, ndërsa komuna mbi pagën bazë kishte përfshirë edhe shtesën prej 44€, pastaj mbi këtë total kishte llogaritur kujdestaritë. Për vitin 2015 kujdestaritë ishin mbivlerësuar në vlerën 1,379€

**Rreziku** Çdo rregullore e cila aplikohet nga komuna dhe e cila duhet të merr miratimin nga Kuvendi Komunal, duhet të rishikohet për harmonizim me legjislacionin relevant dhe rregulloret organike. Mungesa e një rishikimi mund të rezultojë pasaktësi dhe gabime në përlllogaritjen e pagesave.

**Rekomandimi 8** Kryetari duhet të rishikoj rregulloren e brendshme të aplikuar deri më tani nga komuna, dhe të korrigjoj të njëjtën në pajtim me rregulloren organike dhe ta aplikoj në mënyrë adekuate në mënyrë që të mos dëmtohet buxheti i komunës.

### 3.4.2 Subvencionet dhe Transferet

Subvencionet janë transfere të njëanshme të cilat nuk lidhen me mallra dhe shërbime. Ato kryesisht u ndahen entiteteve publike dhe jo publike dhe personave fizik. Kontrollat e caktuara nga komuna përcaktohen me rregulloren e brendshme dhe udhëzimet e përgjithshme të shpenzimit të parasë publike. Gjatë vitit 2015 kontrollat në këtë fushë kishin funksionuar me nivel të kënaqshëm dhe nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

**Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.**

## 3.5 Të hyrat vetjake

Të hyrat e arkëtuara nga komuna gjatë vitit 2015 në total ishin 223,521€. Këto kishin të bëjnë kryesisht me tatimin në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiratë dhe të hyrat nga taksa administrative. Ekziston nevoja për përmirësim në disa procese dhe kontrole që kanë të bëjnë me planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave, me qëllim të rritjes së të hyrave, fusha të cilat janë trajtuar tek (nënkapitulli 3.3 planifikimi i buxhetit të hyrave.

**Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.**

### 3.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një regjistër të plotë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Vlera neto e pasurive të komunës në vitin 2015 ishte 12,493,489€ dhe është shpalosur në PVF.

Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 1.3 Rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare.

**Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.**

### 3.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: Tatimi në pronë, të hyrat nga qiratë dhe taksat e aktivitetit të biznesit. Komuna përgjatë vitit kishte ndërmarrë aktivitete për të inkasuar borxhin. Saldo e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit ishte 498,000€. Megjithatë, vlen të theksohet se ligji për faljen e borxheve mund të ketë ndikuar në rënien e normës së inkasimit të borxheve të mbetura nga vitet e kaluara.

**Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.**

### 3.5.3 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 29,688€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Sipas pohimeve të komunës të njëjtat kanë mbetur të papaguara si pasojë e mungesës së buxhetit edhe pse këto obligime mund të ishin kryer nga tepricat e deklaruar të hyrave vetjake. Po ashtu, komuna ka shpallur edhe disa detyrime kontingjente në vlerë të parashikuar prej 72,000€.

#### Rekomandimi

---

##### Çështja 8 - Proces jo efektiv i raportimit të obligimeve - Prioriteti i mesëm

**E gjetura** Saldo e obligimeve të raportuara në PVF të 2014 nuk ishte e harmonizuar me saldon e faturave të pranuar nga komuna. Krahasimi i sistemit të komunës si dhe shënimeve në SIMFK ka nxjerrë në pah fatura të papaguara të cilat nuk ishin raportuar në PVF të vitit të kaluar.

Auditimi ynë ka identifikuar me dy pagesa me vlerë prej 2,950€, të cilat nuk ishin raportuar si obligime në PVF-të e 2014 dhe si të tilla dhe ishin paguar në vitin vijues.

Komuna krahas obligimeve të lartcekura, përballet edhe me detyrime kontingjente në vlerë 72,000€, nga të cilat shuma prej 66,000€ lidhen me pretendentë për borxhin e parealizuar nga komuna.

**Rreziku** Obligimet e papaguara dhe detyrimet kontingjente, shtojnë rrezikun që buxheti të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore. Mbështetja vetëm në procese formale dhe të pa dokumentuara të raportimit të obligimeve financiare rrisin rrezikun që pozita financiare e komunës të vështirësohet në rrjedhat e ardhshme të operacioneve, si dhe që PVF-të të mos pasqyrojnë gjendjen reale.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë raportim të plotë të obligimeve dhe të forcoj kontrollet dhe disiplinën e zyrtarëve përgjegjës për të përcjellë faturat e papaguara tek departamenti i financave. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente në koordinim me Përfaqësuesin Ligjor të Komunës, duhet të ndërmerret një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, duke iu shmangur ekzekutimeve direkte nga MF.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.



158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
Çështja 2 – Përgatitja e PVF-ve – Prioritet i Lartë	Kryetari duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF-ve për 2015-të përfshijë prezentim të plotë dhe të saktë të pasurive nën 1,000€ dhe të stoqeve në fund të periudhës. Raporti i performancës, si kërkesë statutore e komunës, duhet të publikohet brenda një afati të arsyeshëm kohor.			X
3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit për vitin 2014 do të përcaktojë një afat të arsyeshëm kohor brenda të cilit do të caktohen edhe personat përgjegjës dhe aktivitetet praktikë për adresimin e rekomandimeve të AP, me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet direkt nga Kryetari.		X	
4.1 Qeverisja e mirë	Kryetari duhet t'i rishikojë aranzhimet aktuale të qeverisjes. Meqenëse është një dokument mjaft kompleks, ne do të sugjerim që komuna t'i çaset hartimit të një strategjie për zhvillim, dhe të njëjtën ta miratojë brenda një afati të arsyeshëm, orientimisht brenda vitit 2015. Procedurat e miratimit të buxhetit vjetor duhet të fillojnë me kohë dhe t'i referohen Kornizës Afatmesme Buxhetore të komunave. Gjithashtu, si pjesë e rëndësishme e kontrollit të brendshëm, komuna duhet të themelojë Sistemin e Auditimit të Brendshëm (Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe KA).	X		

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se si të hyrat, ashtu edhe shpenzimet e buxhetit, janë analizuar mirë, dhe se plani i rrjedhës së parasë është i harmonizuar me dinamikën e planifikuar të shpenzimeve. Përveç kësaj, përmirësime nevojiten edhe tek procesi i prokurimit dhe tenderimi i projekteve kapitale të bëhet me kohë		X	
4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari duhet të sigurojë se trendi I të hyrave gjatë viteve të fundit është marrur parasysh dhe që zhvillimet e përgjithshme të komunës (zhvillimin ekonomik, ndërtimet e reja, mundësinë e inkasimit të borxheve të mëparshme) dhe faktorët tjerë që mund të ndikojnë në zgjerimin e bazës për rritjen e të hyrave janë marrur në konsideratë	X		
4.4.1 Prokurimi	Kryetari duhet të përcaktojë pse kërkesat para fillimit të projekteve nuk janë përmbushur, si dhe të zotoj fondet e mjaftueshme para fillimit të secilit projekt kapital.	X		
4.5.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës i qasjes së aplikuar për të arkëtueshmet dhe t'i identifikojë barrierat në përmirësimin e shkallës së mbledhjes. Borxhet e vlerësuara si të vjetra dhe të paarkëtueshme duhet të fshihen (duke dokumentuar arsyet), ndërsa për pjesën tjetër duhet të zbatohet një qasje e hershme dhe efektive, përfshirë veprimet ligjore	X		
4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet për themelimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm.			X